



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.959/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesues, Zyhdi Haziri dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares së Lartë Ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkitazi me apelin e Besnik Jasiqi, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Junik, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Junik paraqitur kundër vendimit pas shpalljes së rezultatit përfundimtar të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) me datë 08.11.2017, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 12.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si i pabazuar apeli i parashtruar nga Besnik Jasiqi, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Junik, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Junik, me shenjën ZL.Anr.959/2017, të datës 10.11.2017, paraqitur kundër vendimit pas shpalljes së rezultatit përfundimtar të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) me datë 08.11.2017, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar apelin ZL.Anr.959/2017 me datën 10.11.2017, nga parashtruesi i apelit Besnik Jasiqi, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Junik, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Junik, i cili pretendon se pas shpalljes së rezultatit përfundimtar nga KQZ në vendvotimin 3101c/06R si kandidat është i dëmtuar për 10 vota. Apelit ia ka bashkangjitur kopjet e FPR-së dhe FRK-ve nga vendvotimi i cekur në apel.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit si dhe shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pabazuar

Paneli pas vlerësimit të pretendimeve të apellesit, gjeti se apeli është i pabazuar sepse nuk ka ofruar dëshmi lidhur me pretendimet e parashtruara në apel. Prandaj Paneli apelin e konsideron si të përgjithësuar dhe të pa argumentuar me fakte dhe si të tillë jo bindës pasi

që nuk i plotëson kërkesat ligjore të përcaktuara me dispozitën e nenit 117 i Ligjit nr. 03/-073 për Zgjedhjet e Përgjithme në Republikën e Kosovës.

Rrjedhimisht PZAP-i në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete dhe bindëse për pretendimet e paraqitura në apel, konstaton se apeli në fjalë është i pabazuar dhe i pa argumentuar dhe si i tillë apeli u refuzua.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL.Anr.959/2017 më datën 12.11.2017.

Krvesuese e Panelit
Gyltene Sylejmani



Udhëzim Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*